




REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPSTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/16

Datë: 31.03.2020

Në bazë në Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, nenit 13, Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, nenit 43, neni 44 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës me datë: 31.03.2020, merr këtë:

V E N D I M

- I. Me qëllim të parandalimit të infeksionit Corona Virus COVID - 19, obligohen të gjitha Furrat e Bukës të cilat veprojnë brenda territorit të Komunës së Junikut, që nga data: 01.04.2020, bukën dhe pjekurinat e tjera ti ofrojnë të mbështjella në folie.
- II. E njëjta vlen edhe për dyqanet ushqimore të cilat njeherit ofrojnë edhe produkte nga furrat të cilat janë cekur me lartë.
- III. Mosrespektimi i këtij vendimi do të konsiderohet si shkelje e dispozitave ligjore dhe nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe do të merren masa ndëshkuese nga organi kompetent.
- IV. Për zbatimin e kësaj urdhërese do të kujdeset Drejtoria për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Junikut dhe Policia e Kosovës – Stacioni Policor në Junik.
- V. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. Drejtoria për Sh.P.I.M.Sh,
2. Stacioni Policor në Junik,
3. Arkivi komunal.

Kryetari:
Agron Kuçi

